



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:191939
Datë: 30.07.2024
Numri i dokumentit: 05996980

C.nr.447/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË –DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj, dhe bashkëpunëtoren profesionale Ardita Hoti Sertolli, në çështjen juridike kontestimore të paditësve S.K, S.G, J.K, I.G dhe S.K mësimdhënës ne SH.F.M.U “T.K” ne Malishevë të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av.Bestar Kolgeci dhe Flaka Gutaj nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim, lidhur me çështjen kontestuese, kompensim për ushqim gjatë punës, jashtë seance me dt. 15.07.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

-Pa shqyrtim kryesor të çështjes-

I. APROVOHET ne tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve S.K, S.G, J.K, I.G dhe S.K të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. Bestar Kolgeci dhe Flaka Gutaj nga Prizreni. **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim, që:

- Paditësit S.K në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për periudhën kohore prej datës 01.01.2020 e deri me datë 31.12.2020, për gjithsej 185 dite punë, t’ia paguaj shumën prej 370.00 euro,
- Paditësit S.G në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për periudhën kohore prej datës 01.01.2020 e deri me datë 31.12.2020, për gjithsej 185 dite punë, t’ia paguaj shumën prej 370.00 euro,
- Paditësit J.K, në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për periudhën kohore prej datës 01.01.2020 e deri me datë 31.12.2020, për gjithsej 185 dite punë, t’ia paguaj shumën prej 370.00 euro,
- Paditësit I.G, në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për periudhën kohore prej datës 01.01.2020 e deri me datë 31.12.2020, për gjithsej 185 dite punë, t’ia paguaj shumën prej 370.00 euro,
- Paditësit S.K, në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për periudhën kohore prej datës 01.01.2020 e deri me datë 31.12.2020, për gjithsej 185 dite punë, t’ia paguaj shumën prej 370.00 euro,

Te gjitha me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë me 19.07.2022 e deri në përmbushjen definitive.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim, që paditësve, t'ua kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 280.00€.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre, në këtë gjykatë me datë 19.07.2022, kanë parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore, ne padi ka shtuar se paditësit janë në marrëdhënie pune me te paditurën ne SHFMU "T.K" ne Malishevë. Tutje në padi ka thënë se meqenëse paditësve nuk i janë paguar - kompensuar deri më tani shpenzimet e ushqimit në punë edhe pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, i njëjti ka shtuar se kërkesëpadinë e mbështetë në nenin 35 par. 7 të kësaj kontrate e cila ka hyrë në fuqi me dt. 18.04.2017 dhe me 21.01.2021.

I autorizuari i paditësve i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të aprovohet kërkesëpadija e paditësve S.K, S.G, J.K, I.Gdhe S.K si e bazuar si dhe të detyrohet e paditura që paditësit S.K në emër të kompensimit të shujtave gjatë ditëve të punës t'ia paguaj shumen prej 370.00 Euro, paditësit S.G në emër të kompensimit të shujtave gjatë ditëve të punës t'ia paguaj shumen prej 370.00 Euro, paditësit J.K në emër të kompensimit të shujtave gjatë ditëve të punës t'ia paguaj shumen prej 370.00 Euro, paditësit I.G në emër të kompensimit të shujtave gjatë ditëve të punës t'ia paguaj shumen prej 370.00 Euro, paditësit S.K në emër të kompensimit të shujtave gjatë ditëve të punës t'ia paguaj shumen prej 370.00 Euro te gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën e plotë të shumës.

Shpenzimet e procedurës i kërkuar sipas tarifës së odës së avokatëve.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 29.02.2024, ka deklaruar se e konteston në tërësi padinë e paditësve, me arsyetimin se kontrata kolektive mbi bazën e se cilës është mbështetur padia ka qene e lidhur për periudhën tri vjeçare dhe si e tille tani me nuk mund te zbatohet.

Andaj edhe me dt.21.11.2022 kjo kontratë është shkëputur pasi e njëjta nuk ka bazë ligjore. Tutje ka shtuar se te paditurës ne këtë çështje i mungon legjitimiteti si pale ne procedure, ka shtuar se ne rastin konkret kemi parashkrim te kërkesës. E njëjta i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave padinë e paditësve ta refuzoj si të pa bazuar.

Lidhur me shpenzimet nuk është deklaruar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, që në këtë rast rezulton se padia e paditësve është ne tërësi e bazuar për arsye se:

Me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar*

fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: “Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie të rregullt pune me të paditurën si mësimdhënës.

Nga vërtetimi me nr. 30/2021 i dt. 20.01.2021 i lëshuar nga SHFMU “T.K” në Malishevë, gjykata e vërtetoi faktin se paditësi S.K për periudhën nga data 01.01.2020 e deri me 31.12.2020 ka realizuar gjithsej 185 dite pune.

Nga vërtetimi me nr. 30/2021 i dt. 20.01.2021 i lëshuar nga SHFMU “T.K” në Malishevë, gjykata e vërtetoi faktin se paditësi S.G për periudhën nga data 01.01.2020 e deri me 31.12.2020 ka realizuar gjithsej 185 dite pune.

Nga vërtetimi me nr. 30/2021 i dt. 20.01.2021 i lëshuar nga SHFMU “T.K” në Malishevë, gjykata e vërtetoi faktin se paditësi J.K për periudhën nga data 01.01.2020 e deri me 31.12.2020 ka realizuar gjithsej 185 dite pune.

Nga vërtetimi me nr. 30/2021 i dt. 20.01.2021 i lëshuar nga SHFMU “T.K” në Malishevë, gjykata e vërtetoi faktin se paditësi I.G për periudhën nga data 01.01.2020 e deri me 31.12.2020 ka realizuar gjithsej 185 dite pune.

Nga vërtetimi me nr. 30/2021 i dt. 20.01.2021 i lëshuar nga SHFMU “T.K” në Malishevë, gjykata e vërtetoi faktin se paditësi S.K për periudhën nga data 01.01.2020 e deri me 31.12.2020 ka realizuar gjithsej 185 dite pune.

Vërtetimet e lartcekura të lëshuar nga SHFMU “T.K” në Malishevë, gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, ngase këto dokumente janë lëshuar nga Shfmu “T.K” e cila vepron në kuadër të paditurës, brenda fushëveprimit të saj.

Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është ne tërësi e bazuar.

Nga provat e administruara, gjykata gjeti se paditësve S.K, S.G, J.K, I.G dhe S.K si nuk i është paguar kompensimi në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë nga e paditura dhe ky fakt nuk është kontestuar as nga e paditura.

Nga vërtetimi i gjendjes faktike lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë, vërehet se paditësi S.K nga data 01.01.2020 e deri me date 31.12.2020 i ka gjithsej 185 ditë prezence në punë, prandaj

gjkata ditët e kaluara në punë të paditësit ka shumëzuar me 2€, për rrjedhojë edhe i ka njohur shumën prej 370.00€, në emër të kompensimit të shujtave, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Paditësi S.G nga data 01.01.2020 e deri me date 31.12.2020 i ka gjithsej 185 ditë prezence në punë, prandaj gjykata ditët e kaluara në punë të paditëses i ka shumëzuar me 2€, për rrjedhojë edhe i ka njohur shumën prej 370.00€, në emër të kompensimit të shujtave, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Paditësi J.K nga data 01.01.2020 e deri me date 31.12.2020 i ka gjithsej 185 ditë prezence në punë, prandaj gjykata ditët e kaluara në punë të paditëses i ka shumëzuar me 2€, për rrjedhojë edhe i ka njohur shumën prej 370.00€, në emër të kompensimit të shujtave, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Paditësi I.G nga data 01.01.2020 e deri me date 31.12.2020 i ka gjithsej 185 ditë prezence në punë, prandaj gjykata ditët e kaluara në punë të paditëses i ka shumëzuar me 2€, për rrjedhojë edhe i ka njohur shumën prej 370.00€, në emër të kompensimit të shujtave, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Paditësi S.K nga data 01.01.2020 e deri me date 31.12.2020 i ka gjithsej 185 ditë prezence në punë, prandaj gjykata ditët e kaluara në punë të paditëses i ka shumëzuar me 2€, për rrjedhojë edhe i ka njohur shumën prej 370.00€, në emër të kompensimit të shujtave, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë lloj kompensimi gjykata i'a njohu paditësve në harmoni me nenin 35 par. 7, të KKAK-së të datës 18.4.2017 ku ishte përcaktuar se "*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore*".

Gjykata duke ju referuar Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë të lartcekura (KKAK), të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, dispozitat e të cilave aplikohen në tërë Republikën e Kosovës, thekson se në këto kontrata janë paraparë të drejta punëtoreve të arsimit në kompensim në emër të ushqimit, në pagë jubilarë dhe shpenzimeve të transportit, dhe se KKAK e parë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, ndërsa KKAK e fundit ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021, me të cilën sërish i janë garantuar punonjësve të arsimit këto të drejta.

Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësve për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensim për ushqim gjatë punës, te njëjtit janë legjitimuar që të kërkojnë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësit kanë rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcaktohet se "*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura u ka

mbetur borxh paditësve, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t'ua kompensoj shumën si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në rastin konkret, gjykata gjatë vendosjes lidhur me këtë çështje vlerësoi dispozitat ligjore të *Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë* ku me nenin 2 paragrafi 1, pika 1.1 të saj parashihet “Dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë shkolla speciale e qendra të kompetencës), dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilat janë anëtarë të SBASHK-ut, dhe pika 1.2 Dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e Institucioneve të Arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukative – arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, kjo kontratë është e nënshkruar nga Qeveria e Kosovës - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, ku sipas kësaj kontrate Komunat, DKA-të, si punëdhënëse janë të obliguar që ta zbatojnë. Andaj dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë shkolla speciale e qendra të kompetencës), që do të thotë se në rastin konkret të gjithë të punësuarve në sektorin e arsimit, ju takon kjo e drejtë.

Gjykata pretendimet e të paditurës të ngritura përmes përgjigjes në padi, se padia është e pas aftashme pasi që është paraqitur pas shkëputjes së kontratës kolektive, për gjykatën të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësit sipas padisë kërkojnë realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, për çka edhe rrjedhimisht derivojnë të drejtat nga akti juridik i tillë. Sa i përket pretendimit se ekziston parashkrimi i kërkesës, gjykata ka konstatuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim, për arsye se kërkesa për kompensim është kërkuar nga data 01.01.2020 e deri me date 31.12.2020, ndërsa padia është paraqitur me datë 19.07.2022 brenda afatit ligjor.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të *Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë* e datës 18.04.2017 si dhe *Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë* e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit. Andaj këto pretendime nuk mund të ketë për efekt vendosjen ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur konform nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ashtu që e ka aprovuar kamatën në lartësi prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë, duke pasur parasysh kërkesën e palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoi në dispozitën nenit 449 dhe 452 e LPK-së, sipas të cilave paditësve u pranohen shpenzimet në shumë prej 280.00 €,

dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 260.00 € aq sa ishte kërkesa e paditësit dhe në emër të taksës për padi shumën prej 20 €.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura e konform nenit 143.1 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË DEGA NE MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.447/22, datë 15.07.2024

Gjyqtari
Nehat Qelaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.